



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERV. OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Priljena/Prifato Received/Delivery	31.05.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHEK	3179/2022		119



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.422/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2203/2021 të datës 13.05.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.422/2021 të datës 17.05.2021 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson Av. me adresë rruga kundër Njoftimit me Nr.0551 të datës 01.04.2021 të Menaxherit të Personelit të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 31.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.422/2021 e datës 17.05.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi përmes përfaqësuesit të autorizuar, përmes postes më datë 12.05.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila ankesë është pranuar më datë 17.05.2021 dhe është regjistruar me numër A.nr.422/2021, me pretendimet ankimore për kompensim të dëmit material dhe jo material për shkak të lëndimit në vendin e tij të punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 19.05.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e

ankuesit tek Shërbimi Korrektues i Kosovës. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nga Shërbimi Korrektues i Kosovës më datë 21.05.2021 ka pranuar përgjigje në ankesë.

Këshilli, në mungesë të kuorumit për vendosje, më datë 06.07.2021 ka njoftuar përfaqësuesin e autorizuar të ankuesit lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës dhe ka udhëzuar të njëjtin që t'i ndjek procedurat e mëtejme në pajtim me dispozitat e Ligjit për Konfliktin Administrativ. Ankuesi, ka ndjekur procedurat gjyqësore dhe si rrjedhojë ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 13.05.2022 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.2203/2021 me të cilin ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me ankesën A.nr.422/2021 të datës 17.05.2021 të parashtruar nga ankuesi

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 17.05.2021 me numër protokolli 2420/2021 të regjistruar me numër A.nr.422/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen me Nr.0551 të datës 01.04.2021 të Menaxherit të Personelit të Shërbimin Korrektues të Kosovës; Autorizimin e datës 01.03.2021; Vërtetim Nënshkrimi LRP-Nr.rend.2630/2021; Vendimin me numër 07Nr.863/2021 i Komunitetit të Istogut; Kërkesën për verifikimin e kushteve dhe mjeteve të punës në Shërbimin Korrektues të Kosovës-Qendra Korrektuese Dubravë e datës 10.03.2021 nga ankuesin për Trupën Ekzekutive të MPMS; Formën e lëndimit në punës Forma.5.1.20 e datës 15.02.2021; Shkresën nga Departamenti Shëndetësor i Burgjeve i datës 15.02.2021; Raportin nga Spitali i Përgjithshëm në Pejë-Emergjencia e datës 15.02.2021; Udhëzimin për konsultim Nr. 0016164; Raportin nga konsulta i datës 26.02.2021; Udhëzimin për Konsultim Nr.053172 i datës 26.02.2021; Raportin nga konsulta i datës 17.02.2021; Fletëzën kompjuterike shëndetësore (SISH-001) Nr.00188331 Udhëzimin për Hulumtime Diagnostike i datës 04.03.2021; Udhëzimin për konsultim Nr. 0016439 i datës 03.03.2021; Raportin nga konsulta i datës 19.02.2021; Udhëzimin për konsultim Nr. 0030425; Udhëzimin për konsultim Nr. 0016165; Raportin nga konsulta i datës 26.02.2021; Dëftesën Nr.0024101 e datës 26.02.2021; Dëftesën Nr.0022185 e datës 26.02.2021; Dëftesën Nr.0025440 e datës 25.02.2021; Dëftesën Nr.018790 e datës 26.02.2021; Shkresë e datës 18.03.2021 Specialisti i Pneumofiziologjisë; Kuponi Fiskal i datës 18.03.2021; Faturën Nr. 3885 e datës 18.03.2021; Shkresë për vizitë kontrolluese e mjekut e datës 18.03.2021; Zarkin e datës 12.05.2021; Kontratën e punës për kohë të caktuar për ankuesin e datës 21.06.2018; Rekomandimin për përtëritjen e kontratës i datës 14.05.2018; Përgjigjen me Nr. 0551 të datës 01.04.2021 nga Menaxheri i Personelit të Shërbimit Korrektues të Kosovës; E-mailin e datës 01.04.2021 nga ankuesi për Kërkesën për zhdëmtim të demit material dhe jo material për lëndimet në punë e datës 16.03.2021 nga ankuesi për SHKK; Raporti i ndërprerjes së përkohshme të punës i datës 17.02.2021; Dëftesën me Nr.095263 e datës 25.02.2021; Dëftesën Nr.0024078 e datës 26.02.2021; Dëftesën Nr.0024647 e datës 26.02.2021; Dëftesën Nr.093936 e datës 05.02.2021; Dëftesën Nr.0024712 e datës 26.02.2021; Dëftesën Nr.093474 e datës 19.02.2021; Përgjigjen në ankesë e datës 21.05.2021 dhe Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 19.05.2021; Njoftimin e datës 06.07.2021 për përfaqësuesin ligjor të ankuesit; Aktgjykimin A.nr.2203/2021 të datës 13.05.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit, *është palejuar, sepse:*

Ankuesi në bazë të Kontratës së Punës të datë 21.06.2018 është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, në pozitën "Zyrtar Korrektues". Sipas shkresave të lëndës i njëjti më datë 15.02.2021 është lënduar në vendin e tij të punës, dhe rrjedhimisht për lëndimet e marra, më datë 16.03.2021 ka parashtruar kërkesë në Shërbimin Korrektues të Kosovës, për kompensimin e dëmit material dhe jo material duke kërkuar kështu kompensimin në emër të shpenzimeve të mjekimit 500 Euro, në emër të ushqimit të përforcuar në vlerën 300 Euro, në emër të gjitha llojeve të dhimbjeve fizike në vlerën 4000 Euro dhe në emër të gjitha llojeve të frikës dhe traumave në shumë 2000 Euro, në total 6800 Euro. Menaxheri i Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës më datë 01.04.2021 i është përgjigjur përfaqësueses së ankuesit në kërkesën e datës 16.03.2021 duke e njoftuar që zyrtarit do ti kompensohen shpenzimet si në dëftesat e bashkangjitura. Menaxheri i Personelit i Shërbimit Korrektues të Kosovës më datë 01.04.2021 ka përcjell përmes e-mailit përgjigjen e datës 01.04.2021 tek përfaqësuesja e autorizuar e ankuesit.

Bazuar në provat e lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se në bazë provave të lëndës, përfaqësuesja e autorizuar e ankuesit përgjigjen e datës 01.04.2021 të Menaxherit të Personelit të Shërbimit Korrektues, e ka pranuar më datë 01.04.2021 përmes e-mailit, ndërsa e njëjta nuk ka ndërmarr veprime për kundërshtimin e kësaj përgjigje deri me datë 12.05.2021, gjegjësisht nuk ka parashtruar ankesë brenda afatit prej 30 ditësh siç parashihet me nenin 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ"*.

Përfaqësuesja e ankuesit përmes ankesës së parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, thekson se nuk ka mund të parashtrroj ankesë me herët për shkak që ka qenë e infektuar me COVID-19 nga data 15.04.2021.

Lidhur me pretendimin se përfaqësuesi i autorizuar ka pasur pengesa për parashtrimin e ankesës brenda afatit prej 30 ditësh, për faktin se ka qenë e infektuar me COVID-19, Kolegji vlerëson se e njëjta është dashur që të ndërmarr veprime juridike për rivendosje të afatit lidhur me ankesën e ankuesit, siç parashihet me dispozitat e nenit 79 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Përpos kur ndalohet shprehimisht nga ligji, në rastet kur për arsye të justifikuara e jo për faj të vet, një palë që është penguar për respektimin e një afati procedural, mund të kërkojë rivendosjen e afatit të humbur"*. Kështu që ankuesi apo përfaqësuesi i autorizuar fillimisht ka mundur të parashtrroj kërkesë për rivendosjen e afatit siç parashihet me paragrafin 2 të nenit 79 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Rivendosja në afat, mund të kërkohej për humbjen e afatit për parashtrimin e kërkesës fillestare, mjetit juridik administrativ, atij për kryerjen e një veprimit tjetër procedural gjatë procedurës administrative, si dhe për çdo afat tjetër që ecën kundrejt palës"*, ndërsa neni 79 paragrafi 3 dhe 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kanë përcaktuar afatet ligjore



për parashtrimin e kërkesës për rivendosje të afatit ku thuhet që: "3. Kërkesa për rivendosjen në afat mund të parashtrohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga largimi i pengesës, por jo më vonë se një (1) vit nga skadimi i afatit të humbur. 4. Në rastin kur pala është penguar nga një forcë madhore, kërkesa për rivendosje në afat mund të parashtrohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga largimi i pengesës, pavarësisht nga koha që ka kaluar nga skadimi i afatit të humbur".

Andaj, meqenëse në provat e lëndës nuk ka asnjë dëshmi që vërteton se ankuesi apo përfaqësuesi i autorizuar ka parashtruar kërkesë për rivendosje të afatit, Kolegji vlerëson se parashtrimi i ankesës në Këshill, me datë 12.05.2021 për kundërshtimin e përgjigjes me shkrim të datës 01.04.2021 të Menaxherit të Personelit, është jashtë afatit prej 30 ditësh dhe rrjedhimisht në kundërshtim me nenin 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ", dhe si e tillë ankesa nuk është e lejueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.422/2021

Avdyl BEKTESHI


Procesmbajtës


Jeton KOCA
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësueses së ankuesit.
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

